


MEMORANDUM I BASHKËPUNIMIT

01/1014/24

I lidhur me dt. 17.07.2024 në mes:

17.07.2024

Agjencisë Kadastrale të Kosovës, e përfaqësuar nga z. **Avni Ahmeti**, zv. Drejtor Ekzekutiv në Agjencinë Kadastrale të Kosovës, (në tekstin në vijim: AKK) dhe Komunës së Klinës, e përfaqësuar nga z. **Zenun Elezaj**, Kryetari i Komunës (në tekstin në vijim: Komuna)



Dispozitat hyrëse

Neni 1

Qëllimi i Memorandumit të bashkëpunimit

1. Qëllimi i këtij memorandumi është krijimi i bashkëpunimit për implementimin e Kapitullit VII (Rindërtimi i Kadastrit) të Ligjit nr.08/L-237 për Kadastër të Pronës së Paluajtshme, dhe Udhëzimit Administrativ nr.11/2024 për Procedurën e Rindërtimit të Kadastrit, me të cilat përveç tjerash përcaktohet që:

1.1. Institucionet qendrore dhe lokale janë të obliguara që të bashkëpunojnë ndërmjet vete, me qëllim të përfundimit të Rindërtimit,

1.2. ZKK-ja, në territorin e së cilës zhvillohet rindërtimi është e obliguar që AKK-së t'ia dorëzoj të dhënat dhe dokumentacionin e nevojshëm për zbatimin e Rindërtimit, në afatin që do të caktohet nga AKK dhe

1.3. Përfaqësuesit e Komunës duhet të mbështesin organizimin e takimeve me banorët e ZK-së, dhe duhet të jenë pjesëmarrës në to.

2. Palët nënshkruese zotohen se do të i përmbushin obligimet që dalin nga ky Memorandum bashkëpunimi.

Të drejtat dhe detyrimet e palëve nënshkruese

Neni 2

Të drejtat e komunës

1. Komuna ka bërë:

1.1. Shqyrtimin e nevojave për realizimin e projektit të Rindërtimit në disa Zona Kadastrale të harmonizuara me Planin Zhvillimor Urban, interesat e komunës dhe të institucioneve tjera dhe

1.2. Propozimin e Zonave Kadastrale në të cilat do të zbatohet projekti i Rindërtimit.

Neni 3

Detyrimet e komunës

1. Para caktimit të Zonave Kadastrale (ZK) për Rindërtim, komuna ka dorëzuar propozimet për zonat kadastrale për përfshirje në projektin e rindërtimit si dhe është konsultuar edhe me autoritetet e nivelit qendror që mund të kenë ndikim në procesin e Rindërtimit.
2. Propozimet e Zonave Kadastrale për Rindërtimin e Kadastrit kanë qenë të harmonizuara me Planet Zhvillimore dhe Urbane të komunës, si dhe janë vlerësuar që janë në interes të përgjithshëm të komunës dhe të institucioneve tjera.
3. Përgadit dhe dorëzon të dhënat nga eksproprijimi (shpronësimi) për pronat në pronësi të komunës.
4. Jep pëlqimin për përfshirjen në procesin e Rindërtimit të pronave të paluajtshme komunale, përgaditë dhe ofron informacionet e nevojshme për rastet që kanë të bëjnë me pronat e uzurpuara në pronësi të komunës.

Neni 4

Të drejtat e AKK

1. AKK ka bërë:
 - 1.1. Vlerësimin e gjendjes së të dhënave kadastrale dhe të Regjistrit të Drejtave në Pronën e Paluajtshme (RDPP) për secilën Zonë Kadastrale që është planifikuar sipas propozimit të komunës për Rindërtim të Kadastrit. Vlerësimi përmban dallimet dhe mos harmonizimet e të dhënave kadastrale në të gjitha ZK-të e përfshira në proces të Rindërtimit.
 - 1.2. Krahasimin e të dhënave nga ortofotot, të dhënat të dorëzuara nga institucionet, nga hartat kadastrale me gjendjen faktike.

Neni 5

Detyrimet e AKK

1. Pas marrjes së vendimit për fillim të Rindërtimit të Kadastrit, AKK do të merr vendim mbi ndërprerjen e përkohshme të aktiviteteve kadastrale në zonat e përfshira në procesin e Rindërtimit të Kadastrit.
2. Komuna dhe operatori ekonomik do të informohen mbi vendimin, me të cilin caktohen llojet e shërbimeve kadastrale që ndërprehen dhe kohëzgjatja e kësaj ndërprerje.
3. Bashkëpunon me komunën në rastet kur në Rindërtim përfshihen pronat e komunës.

Neni 6
Zonat Kadastrale

1. Zonat Kadastrale që përfshihen në Rindërtim janë:

1. **Klinë,**
2. **Dresnik dhe**
3. **Dush i vogël**

Dispozitat përfundimtare

Neni 7
Hyrja në fuqi dhe numri i kopjeve

1. Ky Memorandum i bashkëpunimit hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga palët nënshkruese, ndërsa pushon së vepruari me përfundimin e procesit të Rindërtimit të Kadastrit.
2. Memorandumi është i hartuar në dy kopje, nga një kopje për secilën palë nënshkruese.

Neni 8
Zgjidhja e kontesteve eventuale

Kontestet eventuale rreth zbatimit të këtij Memorandumi zgjidhen me marrëveshje në mes të palëve nënshkruese.

Neni 9
Palët nënshkruese të Memorandumit

Në emër të:

Agjencisë Kadastrale të Kosovës



z. Avni AHMETI
zv. Drejtor Ekzekutiv

Në emër të:

Komunës së Klinës



z. Zenun Elezaj
Kryetar